



Në bazë të nenit 44 dhe 64.2, pika (a) dhe (b) dhe neni 128.2 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe Ligjit nr. 03/L-256 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe nenit 17 dhe 20 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me datë 26.09.2019, miraton:

## RREGULLËN ZGJEDHORE NR. 20/2019 PËR

### NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLËS ZGJEDHORE NR. 13/2013

### FUSHATA E ZGJEDHJEVE DHE NJOFTIMI PËR NGJARJET POLITIKE

#### Neni 1

Neni 5 paragrafi 2 riformulohet si në vazhdim:

5.2 Në Fushatën e zgjedhjeve të asnjë subjekti politik të certifikuar nuk mund të përfshihen kategoritë:

- të punësuarit në institucionet shtetërore dhe publike gjatë orarit të rregullt të punës,
- pjesëtarët e Forcave të Sigurisë së Kosovës (FSK),
- pjesëtarët e uniformuar të Policisë së Kosovës dhe personeli i tyre, përveç kur janë të angazhuar sipas detyrës zyrtare,
- të punësuarit në organizatat bamirëse dhe fetare,
- përfaqësuesit e bashkësive fetare,
- anëtarët e KQZ-së, stafi i Sekretariatit të KQZ-së dhe Komisionet Komunale të Zgjedhjeve (KKZ), përveç në rastet kur janë të angazhuar sipas detyrës zyrtare,
- personat të cilët nuk i kanë mbushur 18 vjet në Ditën e Zgjedhjeve, përveç kur janë të shoqëruar nga prindërit e tyre apo me pëlqimin e prindërve.

#### Neni 2

Shtohet paragrafi 3 dhe 4 i nenit 5 si në vazhdim:

5.3. Duke mos paragjykuar dispozitat e paragrafit 2 të këtij neni, asnjë subjekti politik i certifikuar nuk mund të përfshinë personat të cilët nuk i kanë mbushur 15 vjet në veprimet e mëposhtme:

- te vendosin postera dhe shpërndajnë materiale tjera promovuese
- bartin pankarta dhe materiale tjera promovuese gjatë aktiviteteve të fushatës zgjedhore

- c) të jenë pjesë aktive e materialeve promovuese politike për të shmangur etiketimin e mundshëm, ngacmimin dhe çfarëdo ndikimi tjetër negativ të tyre.
- d) të jenë pjesë aktive e materialeve promovuese politike në fushatë zgjedhore me qëllim për të marrë vota emocionale të elektoratit.
- e) Të përdoren si sfond/prapavijë, në këmbë apo ulur, gjatë aktiviteteve të fushatës zgjedhore.
- 5.4. Asnjë subjekti politik i certifikuar nuk mund të mund të përfshijë personat të cilët i kanë mbushur 15 vjet në aktivitetet e fushatës, si vullnetar apo me pagesë, pa pasur të nënshkruar një marrëveshje të pëlqimit nga subjekti politik, prindërit dhe të miturit. Kjo marrëveshje duhet të jetë e detajuar dhe gjithëpërfshirëse.

### Neni 3

#### Hyrja në fuqi

Kjo rregull e ndryshuar dhe e plotësuar hyn në fuqi në ditën e miratimit.

Prishtinë, 26.09.2019

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

**Valdete Daka**

